



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë
Mbledhja nr. 89
Prishtinë, më 26.6.2024, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, Xhavit Haliti, Adelina Grainca, Yllza Hoti dhe Gazmend Gjyshinca.

Munguan: Fitore Pacolli-Dalipi, Ariana Musliu-Shoshi, Doarsa Kica-Xhelili, Time Kadrijaj dhe Bahrim Shabani.

Pjesëmarrësit nga Programit për Diplomaci Qytetare të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës: Flaka Ismaili dhe Dea Çano koordinatore të projektit, Drita Kabashi, Edona Demhasaj, Algert Dobra, Shan Karemani, Rona Karahoda, Isa Bojaj, Milot Morina, Don Osmani, Shqipe Çarkani, Blerim Halili, Arlind Alidema, Ardit Halimi, Berlind Gajraku, Albina Morina, Albiona Zeka, Edvina Musaj dhe Agonis Jashari.

Pjesëmarrës të tjerë: Leudita Mejzini, Adriana Osmani, Albana Bucaliu, Kuvend.

Nga Zyra e Komisionit: Manush Krasniqi.

Takimin e kryesoi Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

Takim me përfituesit e Programit për Diplomaci Qytetare nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, i falënderoi të pranishmit në emër të KPJD-së, që kanë ndarë kohë për ta bërë këtë takim. Ajo bëri të ditur se ky takim është ftuar për t'i përgëzuar dhe falënderuar për punën dhe kontributin e tyre për Kosovën, duke pezulluar aktivitetet edukative dhe profesionale në vendet ku jetojnë, për të ardhur dhe kontribuar në vendin e origjinës. Ky, tha se është një nga veprimet më fisnike dhe të mëdha që secili prej nesh mund të bëjë, dhe gjithashtu

një obligim moral. Ky takim është menduar si një format miqësor, ku nuk kemi ardhur për të bërë pyetje apo për të kërkuar llogari për punën tuaj. Qëllimi është të bisedohet, të shihet se çfarë mund të punohet së bashku, për të ofruar ndihmë dhe përkrahje në aktivitetet tuaja dhe për t'i falënderuar për gjithçka që ata bëjnë për Kosovën.

Flaka Ismaili, falënderoi komisionin për ftesën dhe theksoi se janë të kënaqur që janë në këtë takim me komisionin. Ky program, tha se ofron një kënaqësi të madhe për pjesëmarrësit, duke qenë pjesë e një grupi të shkëlqyer të profesionistëve të rinj nga diaspora, të cilët vijnë nga vende të ndryshme dhe sjellin në Kosovë aftësitë, entuziazmin dhe bagazhin e tyre kulturor. Ata do të kontribuojnë në Kosovë dhe do të marrin diçka prej saj, pasi që Kosova ka shumë për të ofruar. Qëllimi kryesor i programit është të krijojë lidhje të forta me vendin, të cilat do të vazhdojnë edhe pas 10-20 vitesh, duke mundësuar që secili pjesëmarrës të japë një kontribut për Kosovën. Kontributi i tyre nuk përfundon me këta 10 muaj të qëndrimit në Kosovë, por qëllimi është që të vazhdojë në të ardhmen. Ajo theksoi se edhe pse Kosova është e vogël në numër, ajo ka shumë për të ofruar dhe lidhjet e forta janë një aset i çmuar për vendin, siç është dëshmuar në fushën e kulturës, sportit, teknologjisë dhe fusha të tjera. Programi për Diplomaci Qytetare është pjesë e MPJD-së dhe se përfituesit e këtij programi kanë ardhur në nëntor të vitit të kaluar dhe do të qëndrojnë deri në fund të gushtit. Po ashtu, ajo bëri të ditur se është përfunduar thirrja për aplikim për gjeneratën e re që pritet të vijë në mes të gushtit.

Anëtarët e programit, u prezantuan, duke theksuar se nga vijnë dhe duke njoftuar se në cilin institucion të Republikës së Kosovës janë të angazhuar. Ata po ashtu, i njoftuan deputetët se cilat ishin sfidat e tyre gjatë punës në institucionet e Republikës së Kosovës.

Pas prezantimit të pjesëtarëve të programit për Programin për Diplomaci Qytetare nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, anëtarët e komisionit zhvilluan një bashkëbisedim të lirë me të pranishmit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Arbëreshë Kryeziu-Hyseni,

Kryetare e Komisionit